



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2483 / prot. 4

Gramsh, më 02/09 2026

VENDIM

Nr. 65 , Datë 28/08/2026

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET BASHKISË GRAMSH DHE SHOQËRISË AIROI SH.P.K. PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE TË RIPPYLLËZIMIT, RESTAURIMIT EKOLOGJIK DHE SEKUESTRIMIT TË KARBONIT

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”; të VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, të ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020; si dhe të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, Pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Gramsh dhe shoqërisë “AIROI” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Gramsh dhe shoqërisë “AIROI” sh.p.k., filial i “AIROI Inc.”, për bashkëpunimin në fushën e rippyllëzimit, restaurimit ekologjik, mbrojtjes së biodiversitetit dhe sekuestrimit të karbonit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Memorandumi i Mirëkuptimit, bashkëlidhur këtij vendimi, është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kryetari i Bashkisë Gramsh ngarkohet me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me kompetencat e tij dhe legjislacionin në fuqi.
 4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat përkatëse të Bashkisë Gramsh.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Xhulia Gjini

KRYETARI I KËSHILLIT
Enis Zani

